



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 30.09.2013  
Nr. 0203 - 1249

**PËR:** Bajrush Ymeri , Kryetar i Komunës së Novobërdës  
Shefkije Mehmeti, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Novobërdës

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË RREGULLORES SË KOMUNËS  
SË NOVOBËRDËS, Nr. 01 - 925, Pranuar me datë, 26.09.2013**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Rregullores Nr. 01 - 925, të miratuar me datë 24.09.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Rregullorja Nr. 01 - 925, për Barazi Gjinore në Komunën e Novobërdës.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL,**

**Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL**  
**Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së**  
**Arkivit të MAPL-së.**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 30.09.2013  
br. 0203 - 1249

**Za:** Bajrush Ymeri , Gradonačelnik opštine Novo Brdo  
Shefkije Mehmeti, Predsedavajuća Skupštine opštine Novo Brdo

**Predmet:** Potvrda zakonitosti uredbe opštine Novo Brdo  
br. 01 - 925, Primitjeno dana , 26.09.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva , nakon razmatranja uredbe br. 01 - 925, odobreno dana 24.09.2013, **POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .**

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je kao što sledi.

- Uredba br. 01 - 925, o rodnoj ravnopravnosti opštine Novo Brdo.


Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a,**

*Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*  
*Rukovodiocima odeljenja MALS-a*  
*Arhivi MALS-a*



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assembly

Në mbështetje të dispozitave nenit 13, lidhur me nenin 58, Shkronja b dhe g të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 (G.Z e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 11, nenit 12, pika 12.2 (b), . të Statutit të Komunës së Novobërdës 01.Nr. 359, të datës 17.05.2010, si dhe në mbështetje të dispozitave të ligjeve që e potencoj qeshtjen e barazisë gjinore duke fillura nga ligjet - Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit Kundër Diskriminimit, Ligjit të Shërbimit Civil, Ligjit kunder dhunës në familje , Ligjit mbi Marrëdhënien e Punës, si dhe dispozitave të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Kryetari i Komunës së Novobërdës , propozon këtë:

## RR E G U L L O R E PËR BARAZI GJINORE

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 1

##### Qëllimi

Me këtë rregullore mbrohet, trajtohet dhe vendoset barazia gjinore si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqëris në Komunën e Novobërdë , mundësit e barabarta të kontributeve të tyre në zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Ngase garantimi i të drejtave të barabarta është detyr e tër shoqëris dhe nënëkupton menjanimin e të gjitha pengesave në realizimin e barazisë gjinore

Kjo rregullore përcakton kushte dhe mundësi për barazi gjinore përmes politikave që mbështesin zhvillimin e gjithanshëm dhe përmirësimin, sidomos të pozitës së femrave, në komunën tonë në mënyrë që ato të jenë të vlerësuara dhe të gëzojnë autoritet në familje dhe shoqëri. Përkatësia gjinore i referohet përcaktimit socio- kulturor të burrit dhe gruas, rolit që lidhet me të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe civile , nevojave dhe interesave të tyre të veçanta.

#### Neni 2

##### Përkufizimet

2.1 "Barazi gjinore" do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi.

2.2 "Trajtim i barabartë gjinor" do të thotë mënjanim i të gjitha formave të diskriminimit qoftë ato të drejtpërdrejta apo të tërthortatë të diskriminimit gjinor.

2.3 "Diskriminim i drejtpërdrejtë gjinor" do të thotë trajtim i pabarabartë i ndonjë individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme.

2.4 "Diskriminim i tërthortë gjinor" do të thotë vënia e individit të njëres gjini në pozitë jo të barabartë me dispozitat asnjëse, standartet apo trajtim të pabarabartë në rrethana të njëjta ose të ngjashme, përveç rasteve kur këto dispozita, standarte apo ky trajtim është idomosdoshëm dhe nëse mund të justifikohet me fakte objektive që nuk bazohen posaçërisht në ndonjë gjini.

2.5 "Parimin e trajtimit të barabartë" që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paafëtisë fizike apo mendore, orientimit seksual, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, races, pronës, lindjes ose statuseve tjera;

2.6 "Masat ligjore" janë masa të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së plotë të femrave dhe meshkujve në shoqëri, të cilat japin përparësi specifike në mënyrë që pjesëtarëve të gjinisë së caktuar t'u mundësohet qasje e barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, të mënjanohet pabarazia gjinore ekzistuese, ose t'u sigurohen të drejta të cilat më herët nuk iu kanë takuar.

2.7 "Masat e përgjithshme" janë masa të natyrës normative, përmes të cilave diskriminimi gjinor parandalohet me anë të ligjeve të cilat i rregullojnë fushat e veçanta, sjelljet në rrethana të caktuara apo qasjen e duhur për garantimin e trajtimit të barabartë gjinor, siç janë ndëshkimet që duhet ndërmarrë ndaj individëve në rast të shkeljes së këtyre kufizimeve ose kërkesave.

2.8 "Masat e veçanta" janë masa të përkohshme të cilat kanë për qëllim garantimin e të drejtave të barabarta gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në fushat specifike të jetës shoqërore, në të cilat është identifikuar përfaqësimi i pabarabartë gjinor apo pozita e pa barabartë e personave që i përkasin njëres gjini.

2.9 "Përfaqësimi i pabarabartë" është atëherë kur përfaqësimi i njëres gjini, në një fushë të posaçme shoqërore apo në një segment të kësaj fushe, është më i ulët se 40%.

### Neni 3

## INSTITUCIONET DHE ORGANET UDHËHEQËSE

3.1 Me zbatimin e masave ligjore dhe afirmative vendoset pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në organet e të gjitha niveleve të institucioneve publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të arrijë nivelin e pjesëmarrjes së tyre të popullata e përgjithshme e Komunës

3.2 Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40 %.

3.3 Gjatë emërimit në pozita të larta të institucioneve komunale, duhet të respektohet pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në përputhje me paragrafin 2.

3.4 Organet kompetente gjatë emërimit të anëtarëve të këshillave, komisioneve dhe organeve përfaqësuese brenda dhe jashtë Komunës duhet të përfillin përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve në këto këshilla, komisione dhe organe përfaqësuese.

3.5 Institucionet komunale, në pajtim me kompetencat e tyre, promovojnë dhe krijojnë mundësi të barabarta, hartojnë politikat e tyre duke u bazuar në barazinë gjinore dhe miratojnë masa dhe ndërmarrin aktivitete të nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe meshkuj.

#### **Neni 4**

##### **Vendim marrja.**

4.1 Vendimet që marrin organet e qeverisjes si, Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës, para miratimit duhet të shqyrtohen në aspektin e barazisë gjinore.

4.2 Shërbimi civil në sajë të paanshmërisë, profesionalizmit, përgjegjshmërisë reflekton barazinë gjinore.

4.3 Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.

4.4 Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblimet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, mosha ose prejardhja etnike.

#### **Neni 5.**

##### **PARTITE POLITIKE**

5.1 Partite politike të regjistruara në regjistrin e partive politike, përcaktojnë metodat dhe masat për përfshirjen dhe përfaqësimin e grave dhe burrave në pajtim me nenin 3.2 të ligjit për barazi gjinore.

#### **Neni 6.**

##### **Ekonomia**

- 6.1 Konform strategjise komunale per barazi gjinore (shih nenin7) qdo drejtori gjatë draftimit te planeve buxhetore komunale duhet të ket parasysh komponenten e ndarjes se drejte buxhetore e cila nuk nënkupton ndarje të vecanet të mejeteve fiandare për grate. por planifikimin dhe zabtimin e nevojave në menyre të barabartë.
- 6.2 Komuna gjatë planifikimit të buxhetit komunal, të bëjë identifikimin e nevojave të të dy gjinive
- 6.3 Në procesin e planifikimit të buxhetit, komuna të siguroj mbajtjen e tubimeve, dëgjimeve publike dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e grave.

6.4 Komuna të bëjë hartimin e planeve dhe plotikave për stimulimin e programeve për grate ndërmarrëse nëpërmjet krijimit të mundësive për qasje në pronë dhe kredi lehtësira.

## **Neni 7 .**

### **ARSIMIMI dhe KULTURA**

- 7.1 Në të gjitha nivelet e arsimit dhe edukimit duhet të mundësohet arsimimi dhe edukimi i barabartë i femrave dhe meshkujve për pjesëmarrje e tyre aktive në shoqëri, në jetën familjare dhe tergun e punës
- 7.2 Organi përgjegjës për arsim dhe intitucionet në fushën e arsimit dhe të edukimit në të gjitha nivelet krijojnë, zbatojnë dhe mbikqyrin politikat e veprimit për sigurimin e barazisë gjinore me qëllim të trajtimit të njëjtë të femrave dhe meshkujve,
- 7.3 Përfshirjes së barabartë të femrave dhe meshkujve në lëmenjtë e sportit dhe te gjitha aktiviteve të lira, qe zhvillohen ne komunen tonë .

## **Neni 8.**

### **Mbrojtja Sociale**

- 8.1 Në legjislacionin komunal të politikave të mbrojtjes sociale të mundësohet qasja e plotë dhe e barabartë duke rritur numrin e shërbimeve për grate e varfëra dhe kryefamiljare.
- 8.2 Femrat dhe meshkujt kanë të drejtë për qasje të barabartë në sistemin e sigurisë dhe mirëqenies sociale gjatë tërë jetës.

## **Neni 9.**

### **Shoqëria civile dhe barazia gjinore**

- 9.1 Komuna të bashëkuptojë me organizatat joqeveritare dhe grupet e tjera të shoqërisë civile për avancimin e barazisë gjinore në komunën e Novobërdës sipas nenit 11 të Ligjit për barazi gjinore.

## **Neni 10.**

## **BARAZIA GJINORE DHE TË DREJTAT CIVILE**

Mosha mesatare për të dy gjinitë në Kosovë është 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç

10.1 Martesa njihet me ligj me aktin e kurorëzimit. I cili lejohet me arritjen e moshës madhore nese me ligje te veqant nuk është parapar ndryshe dhe sjell të drejta dhe detyrime sipas ligjit

10.2 Pasuria e përbashkët e regjistruar si pronë e përbashkët në pajtim me paragrafin 16.7 administrohet bashkarisht dhe nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e bashkëshortëve.

10.3 Në rast të shkurorëzimit të bashkëshortëve pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta.

10.4 Në rast vdekje të njërit prej bashkëshortëve, pasuria trashëgimore ndahet ndërmjet bashkëshortit/bashkëshortes dhe trashëgimtarëve të tjerë në pajtim me ligjin.

10.5 Fëmijët, femra dhe meshkuj trashëgojnë pasurinë në mënyrë të barabartë.

10.6 Trashëgimtarët, femra dhe meshkuj, mund të disponojnë me pjesën e tyre trashëgimore dhe ta tjetërsojnë, pas regjistrimit si pasuri e tyre trashëgimore.

### **Neni 11.**

#### **Punësimi**

11.1 Kriteret dhe kushtet për zgjedhjen e kandidateve për vende pune në çdo degë veprimtarie, në të gjitha shkallët profesionale, në sektorin publik dhe privat, vendosen mbi bazat e barazisë gjinore.

11.2 Ndalohet ngacmimi dhe ngacmimi seksual në vendin e punës.

11. Punëdhënësi/Punëdhënësjja siguron që femrat dhe meshkujt të kenë mundësi të barabarta për të vazhduar shkollimin dhe aftësimin profesional dhe të përcjellin trajnimet të cilat mbahen për të shtuar shkathtësitë profesionale ose të përgatiten për profesione të tjera.

11.4 Ndalohet diskriminimi mbi bazat gjinore në rast të zvogëlimeve dhe mbylljes së vendit të punës.

### **Neni 12**

#### **Planet për barazi gjinor**

12.1 Çdo drejtori duhet që për çdo vit të hartoj një plan për barazi gjinore me synime konkrete. Plani hartohet paralel me buxhetin dhe planin e veprimtarisë. Njëkohësisht me llogarinë vjetore ekonomike duhet të bëhet edhe llogaria vjetore për barazi gjinore.

12.2 Shefat e sektorëve dhe drejtorët e drejtorive janë përgjegjës kryesorë rreth punës për barazi gjinore brenda çdo drejtorie .

12.3 Secila drejtori organizon punën për barazi gjinore varësisht nga karakteri i veprimtarisë dhe madhësia. Përfaqësuesi për barazi gjinore për shembull për vend pune, njësi gjeografike apo njësi caktohet nga personeli përbrenda kufijve të marrëveshjes së bashkëpunimit.

12.4 Zyra për barazi gjinore do të ndihmojë në mbledhjen, evidentimin dhe anlizën e të dhënave tek çdo lloj anketimi tjetër për t'u ardhur në ndihmë drejtorive dhe shërbimeve të tjera komunale në rast nevojë të hartimeve të dokumenteve të barazisë gjinore.


### **Neni 13**

#### **Dispozitat kalimtare**

#### **Hyrja në fuqi**

**1. Kjo Rregullore hyn në fuqi, datën e miratimit nga Kuvendi Komunal dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.**

**Sadhere Vllasaliu**

  
**Zyrtarja për Barazi Gjinore**

**Shefkije Mehmeti**

  
**Kryesuese e Kuvendit**